

Ndikimi i luftës në Ukrainë në ekonominë e Kosovës



—
Maj 2022

Ndikimi i luftës në Ukrainë
në ekonominë e Kosovës

—
Maj 2022

— **Përmbajtja**

Përmbledhje ekzekutive	3
Hyrje	4
Kanalet kryesore të ndikimit të luftës Ukrainë-Rusi në ekonominë e Kosovës	5
Zhvillimet tjera në tregun e brendshëm në Kosovë	9
Ndërhyrjet e qeverive gjatë krizës së çmimeve	11
Përfundim	13

Përmbledhje ekzekutive

Fillimi i pushtimit të Ukrainës nga Rusia më 24 shkurt 2022, e përcjellur me embargo ndaj Rusisë nga shumë shtete të perëndimit, ka shkaktuar godtje në anën e ofertës në treg dhe rrjedhimisht, rritje të ndjeshme të çmimeve të shumë produkteve. Kjo, pasi që Rusia dhe Ukraina janë ndër eksportueset më të mëdha në botë të disa produkteve kryesore bazike sikurse grurit, misrit, gazit, naftës, vajit dhe fertilizuesve, ku së bashku kanë nga 10 deri në 40% pjesëmarrje në eksportin botëror të këtyre produkteve. Evropa, veçanërisht, del të jetë e varur nga Rusia në furnizimin me gaz në shkallën prej 44% të importit vjetor; qymyr 54%; dhe naftë 26%. Pavarësimi energjetik i Evropës nga Rusia në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme, duke synuar zëvendësimin e importeve të këtyre produkteve nga shtetet tjera, të cilat bazuar në të dhënat aktuale të prodhimit në botë nuk mund të zëvendësohen më shumë se në shkallën 33 deri në 50%, ka pak gjasa të ndodhë. Ngjashëm, rezervat e grurit në botë dalin të jenë të pamfjatueshme që ta zëvendësojnë furnizimin nga Rusia për shkak të rendimentit të ulët në periudhën 2021–2022, në vende sikurse Kanadaja apo Shtetet e Bashkuara të Amerikës, por edhe për shkak të tendencës së shteteve sikurse Argjentina që të kufizojnë sasinë e grurit të eksportuar pasi që synojnë të mbrohen nga inflacioni i brendshëm. Të gjitha këto japin indikacion për rritje të ndjeshme të çmimeve të produkteve bazë përgjatë tërë vitit 2022, me pritshmëri që të mbesin të njëjta edhe në periudhën afatmesme.


Kosova është neto importuese e energjisë elektrike, naftës, grurit, misrit, vajit, dhe zhvillimet në tregjet ndërkombëtare pasqyrohen drejtpërdrejtë në ekonominë e vendit tonë. Duke marrë parasysh se kriza është shkaktuar nga një tronditje në anën e ofertës, e cila po shoqërohet edhe me një nivel të lartë të kërkesës agregate qysh nga viti 2021, politikat e qeverisë duhet të jenë të atilla që nuk e stimulojnë kërkesën për këto produkte. Në këtë pikë, reduktimi i normave tatimore në të ardhurat personale për të gjithë qytetarët dhe mbështetja e nismave sikurse ajo për tërheqjen e 30% të kursimeve nga Trusti pensional mund të prodhojnë kundërfekte në ekonomi. Është e rëndësishme që qeveria me të hyrat e arkëtuara përtej planifikimit, si rezultat i çmimeve të larta, të mbështesë edhe më shumë grupet më të pa mbrojtura të shoqërisë që rrezikojnë të bien në varfëri, sikurse qytetarët që janë pjesë e Skemës së Ndhmës Sociale, ata që mund të humbin vendet e punës, etj. Subvencionimi në fushën e bujqësisë në Kosovë dhe ulja e normës së akcizës për naftë për bujqit gjatë vitit 2022, dalin të jenë masa adekuate në mbulimin e rrezikut që bujqit të mos rrisin prodhimin e këtyre kulturave këtë vit, dhe një mbështetje e tillë duhet të bëhet në vazhdimësi deri në normalizimin e çmimeve. Po ashtu, akterët e fushës së energjisë duhet të konsiderojnë zgjedhjen e strategjive mbrojtëse për energji elektrike këtë vit, marrë parasysh indikacionet për çmime të larta të importit të energjisë elektrike edhe në periudhën afatmesme. Ngjashëm, meqë kërkesa e qytetarëve në Kosovë për produktet e naftës del të jetë jo-elastike, duhet të shqyrtohen masa për subvencionimin e transportit publik, si dhe të përkrahen iniciativa që inkurarojnë udhëtimet në grup dhe përdorim më të ulët të veturave.

Hyrje

Me fillimin e pandemisë në vitin 2020, kufizimi i lëvizjes së njerëzve kishte prekur sektorë të rëndësishëm të disa vendeve që fuqinë punëtore e marrin nga shtetet fqinje. Kjo, së bashku edhe me një rënie të gjithëmbarshme të kërkesës, ndikoi në uljen e nivelit të prodhimit apo ofertës në treg. Por, me fillimin e një ringjalljeje të shpejtë të ekonomive në botë përgjatë vitit 2021, pamjaftueshmëria e produkteve në treg kundrejt një kërkesë të lartë ndikoi në rritjen e çmimeve të shumë produkteve.¹ Në Kosovë, gjatë nëntorit të vitit 2021, çmimi i vajit ushqimor veçse ishte rritur për 38% krahasuar me vitin 2020; nafta për rreth 29%; gruri dhe sheqeri me nga 4%.² Njëkohësisht, gjatë verës së vitit 2021, një kërkesë e lartë për konsum të energjisë elektrike për shkak të temperaturave të larta, e shoqëruar dhe me reduktim të theksuar të ofertës së gazit nga ana e Rusisë si dhe prodhim të ulët të energjisë elektrike nga mullinjtë e erës, ndikuan në shumëfishim të çmimeve të energjisë elektrike. Ndonëse, për shkak të çmimeve të rregulluara të energjisë elektrike në Kosovë për konsumatorët shtëpiakë dhe jo-shtëpiakë, kjo rritje nuk është reflektuar në çmimet e faturave të qytetarëve deri në rishqyrtimin e jashtëzakonshëm të tarifave në periudhën shkurt-mars të vitit 2022. Mirëpo, vetëm për energjinë elektrike të importuar gjatë vitit 2021 janë shpenzuar rreth 155 milionë euro.³ Ngjashëm edhe materialet elektrike u rritën për 31.3% në tremujorin e fundit të vitit 2021 krahasuar me vitin 2020, si dhe materialet ndërtimore për 21%.⁴

Përderisa pritet ishin që fytet e ngushta në zingjirin e furnizimit të fillonin të zgjidheshin dhe të ketë një stabilizim të çmimeve, fillimi i pushtimit të Ukrainës nga Rusia më 24 shkurt 2022 ka ndikuar ndjeshëm në rëndimin e situatës në anën e ofertës, dhe si rrjedhojë edhe në rritjen e çmimeve të shumë produkteve, në shumë raste shumëfishim të tyre. Rusia dhe Ukraina përbëjnë dy shtete të cilat janë ndër prodhueset më të mëdhenj në botë të disa produkteve bazë të energjisë, sikurse gazi dhe nafta, si dhe hekurit, grurit, misrit, fertilizuesve, vajit të lulediellit, etj.

Figura 1. Rritja e çmimeve të produkteve bazike në bursën ndërkombëtare për periudhën janar 2021 – mars 2022



Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e Nasdaq dhe HupX

1 Shih punimin e Institutit GAP "Rritja e çmimeve në Kosovë dhe masat e mundshme për përbalimin e inflacionit".

Burimi: <https://bit.ly/3xgKvuK>


2 Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës. ASK Data: Çmimet.

3 Zyra e Rregullatorit të Energjisë. Burimi: <https://bit.ly/3rhLYx4>

4 Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës. Indeksi i Kostos së Ndërtimit TM4 2021. Burimi: <https://bit.ly/3vLZCka>

Marrë parasysh se Kosova është një ekonomi e vogël dhe e varur në shkallë të lartë nga importet, një goditje e tillë në ekonominë botërore ku krijohen çekuilibre të theksuara në mes të kërkesës dhe ofertës ka efekt të pashmangshëm edhe tek ne. Për shkak të pushtimit rus të Ukrainës, edhe Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) ka rishikuar normat e rritjes reale të shteteve, duke përfshirë këtu edhe Kosovën, ku nga një parashikim fillestar për rritje ekonomike reale prej 4.5% në vitin 2022, ajo tani është zbritur në 4%.⁵ Ngjashëm, edhe Banka Botërore (BB), në raportin e saj të fundit parashikon një rritje reale ekonomike të Kosovës gjatë vitit 2022, prej 3.9%, si dhe rritje të nivelit të çmimeve prej 5.4%; që sipas BB mund të rritet edhe më tej për shkak të luftës në Ukrainë.⁶ Vetëm në periudhën janar-mars 2022, niveli i çmimeve të konsumit ishte për 8.2% më i lartë se në vitin 2021.⁷

Figura 2. Pjesëmarrja e Rusisë dhe Ukrainës në eksportet botërore në disa sektorë, 2019



Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e Observatory of Economic Complexity

Ky raport synon të vlerësojë ndikimin ekonomik të pushtimit rus të Ukrainës në ekonominë e Kosovës, duke analizuar peshën e të dy këtyre shteteve në tregjet ndërkombëtare, kanalet kryesore indirekte dhe direkte të transmetimit të efekteve në ekonominë e Kosovës, dhe perspektivën afatshkurtër dhe afatmesme të lëvizjes së çmimeve. Po ashtu, raporti synon t'i paraqesë masat e ndërmarra nga Qeveria e Kosovës dhe qeveritë në rajon dhe të prezantojë rekomandime lidhur me përballimin e kësaj situatë.

Kanalet kryesore të ndikimit të luftës Ukrainë-Rusi në ekonominë e Kosovës

Energjia elektrike

Një ndër kanalet kryesore të ndikimit të luftës Ukrainë-Rusi në ekonominë e Kosovës është përmes energjisë elektrike të importuar. Përkundër se viteve të fundit, shtetet kanë përparuar në rritjen e kapaciteteve të tyre prodhuese të energjisë elektrike, sikurse nga burimet e ripërtitshme të energjisë, një numër i madh i tyre ende janë të varura sidomos nga gazi dhe qymyri për ngrohje dhe për prodhimin e energjisë elektrike.

⁵ Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim. Burimi: <https://bit.ly/3xi83zE>

⁶ Banka Botërore. Burimi: <https://bit.ly/3JyN5iu>

⁷ Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës. ASK Data: Indeksi I çmimeve të konsumit.

Mos furnizimi i mjaftueshëm me gaz nga Rusia i shumë shteteve të Evropës e rëndoi edhe më tej gjendjen në tregun e energjisë elektrike qysh nga fillimi i vjeshtës në vitin 2021. Gjatë vitit, Rusia eksportoi mbi 8.8% të të gjithë eksporteve në botë të gazit dhe rreth 14% të qymyrit.⁸ Varësia e Evropës nga Rusia në furnizimin me gaz është rreth 44% apo rreth 155 miliardë metra kub gaz në vit dhe me lëndë djegëse të forta sikurse qymyri me mbi 54%. Për Gjermaninë, gazi, që është burimi i tretë më i rëndësishëm i energjisë në vend, importohet mbi 55% nga Rusia. Ngjashëm, mbi 45% e qymyrit të përdorur për prodhimin e energjisë elektrike në Gjermani importohet nga Rusia.⁹ Vende të tjera, sikurse Çekia importon mbi 84% të gazit nga Rusia; Hungaria 58%; dhe Italia 37%.¹⁰

Aktualisht janë prezantuar disa skenarë tejet optimistë për pavarësimin e shpejtë energjetik të Evropës nga gazi rus, të cilët bazohen duke llogaritur ndërtimin e terminaleve të gazit të lëngshëm dhe më shumë linjave interkonektive, futjen më të shpejtë në punë të kapaciteteve të energjisë solare dhe asaj me erë dhe rritjen e efikasitetit të energjisë elektrike. Mirëpo, nga 155 miliardë metra kub gaz të importuar në mesatare në vit në Bashkimin Evropian nga Rusia, këto masa, në rast të aplikimit të suksesshëm në një periudhë kohore afatmesme mund të reduktojnë vetëm rreth 80 miliardë metra kub të kësaj sasive.¹¹ Ndërsa për shtete sikurse Gjermania, një skenar tjetër optimist parasheh që ajo të mund të pavarësohet nga gazi rus, vetëm në mesin e vitit 2024.¹² Po ashtu, Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë premtuar se do të sjellin mbi 15 miliardë metra kub gaz të lëngshëm shtesë në Evropë gjatë vitit 2022, me synim që importet e gazit të lëngshëm të Evropës nga SHBA-të mund të arrijnë sasinë e 50 miliardë metrave kub gaz deri në vitin 2030.¹³ Në raport me importet aktuale të gazit nga Rusia, arritja e këtij targeti nënkupton zëvendësimin e vetëm një të tretës së gazit të importuar. Ngjashëm, edhe Kanada ka premtuar të rrisë vëllimin e gazit të lëngshëm që do të destinohet në Evropë me ekuivalentin e rreth 300 fuçi naftë në ditë¹⁴, mirëpo e cila sasi del të jetë tejet e vogël në raport me furnizimin ditor të Rusisë në Evropë.

Aktualisht, rrethanat dalin të jenë të rënduara tek çmimet e energjisë elektrike, ku vetëm Mbretëria e Bashkuar ka njoftuar se faturat e energjisë elektrike do të rriten për mbi 54% nga muaji prill i vitit 2022.¹⁵ Ngjashëm, tregtimi i kontratave afatgjata të energjisë elektrike sikurse për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor vazhdon të bëhet me çmime relativisht të larta.¹⁶

Kërkesa për energji elektrike në Kosovë zakonisht mbulohet nga kapacitetet e brendshme në shkallën prej rreth 85 deri 87% nga prodhimi vendor, gjë që ia siguron Kosovës një pavarësi energjetike në shkallë të lartë. Mirëpo, në vitin 2021, në Kosovë ishin dy zhvillime në fushën e energjisë elektrike me ndikim të madh, një rritje e theksuar e importit në shkallën prej 19% dhe rritje e ndjeshme e kërkesës për energji elektrike për rreth 11.7%. Importi total prej 1,300 GWh gjatë vitit 2021 kishte një kosto rreth 155 milionë euro, që në masë të madhe ishte ndikuar nga dalja e pa planifikuar nga prodhimi e disa njësive gjeneruese të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK). Ngjashëm, për energjinë elektrike të importuar nga operatori i sistemit, transmisionit dhe tregut KOSTT për komunat në veri janë shpenzuar rreth 41 milionë euro. Po ashtu, ndërmarrjet të cilat operojnë me çmime të parregulluara, sikurse Ferronikeli, Sharrcemi dhe

8 Observatory of Economic Complexity. Burimi: <https://oec.world/en/>

9 Journalism for the energy transition. Burimi: <https://bit.ly/3Jothhv>

10 Real Instituti Elcano. Burimi: <https://bit.ly/3v81e0T>

11 International Energy Agency. Burimi: <https://bit.ly/3Jm9sHG>

12 Bloomberg. Burimi: <https://bloom.bg/3jqAFyy>

13 Komision Evropian. Burimi: <https://bit.ly/370remV>

14 Reuters. Burimi: <https://reut.rs/3LO43e2>

15 Kallxo.com. Burimi: <https://bit.ly/3E071tt>

16 CME Group. Burimi: <https://bit.ly/3KsNFzB>

Trepça, janë përballur me çmime tejet të larta të importit, gjë që ka shtyer dhe në ndaljen e përkohshme të prodhimit nga ana e tyre (Ferronikeli).¹⁷ Futja në zbatim e tarifave të reja progresive të energjisë elektrike, që më të drejtë synojnë të nxisin konsumatorët të kursejnë energjinë elektrike, mund ta zbus në një masë nivelin e konsumit tek konsumatorët shtëpiakë. Gjithësesi, marrë parasysh përvojën nga viti i kaluar është e nevojshme që të gjithë akterët e tregut të energjisë elektrike të diskutojnë mbi mundësinë e aplikimit të strategjive mbrojtëse, sikurse duke hyrë në kontrata që parashohin të drejta të ardhshme (futures ose forwards), për të minimizuar rrezikun. Ndonëse tregu i energjisë elektrike në Kosovë funksionon në principin një ditë para (day ahead), sipas Marrëveshjes për Blerjen e Energjisë të Bërë në kohën e privatizimit të distribucionit, gjetja e një zgjidhjeje të tillë për kontraktimin e energjisë në kohën e pikut gjatë muajve të dimrit, do të mund të mënjante mundësinë që të përsëriteshin skenarë të tillë të krizës energjetike ku në Kosovë ishin aplikuar edhe ndërprerje të energjisë elektrike. Përveç ndikimit ekonomik, reduktimet shkaktuan edhe probleme të mëdha likuiditeti tek akterët e vet energjisë elektrike në treg.

Nafta

Një kanal tjetër i ndikimit të luftës Ukrainë-Rusi në ekonominë e Kosovës është përmes naftës së importuar. Rusia eksporton rreth 12.5% të eksporteve totale në botë të naftës së parafinuar gjatë një viti dhe mbi 9.6% të naftës së rafinuar.¹⁸ Evropa është e varur nga nafta e importuar nga Rusia në shkallën prej 26% dhe vetëm shtete sikurse Gjermania importojnë rreth 34% të naftës së papërpunuar nga Rusia, e cila pas përpunimit shfrytëzohet kryesisht për transport dhe më pak për prodhim të energjisë elektrike.¹⁹ Ngjashëm, Holanda importon naftë të parafinuar dhe rafinuar nga Rusia rreth 30 miliardë dollarë në vit; Italia mbi 8 miliardë dollarë; Polonia mbi 8 miliardë dollarë.²⁰ Pjesë e problemit në furnizim është edhe hezitimi i shteteve të krijojnë kontakte më ndërmjetësuesit rus të shitjes së naftës për shkak të embargove që kanë vënë shtetet e mëdha si ShBA ndaj Rusisë.²¹ Sipas Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë, reduktimi në masën prej 38% të furnizimit ditor aktual nga Rusia me naftë të papërpunuar, mund të nxisë një nga krizat më të mëdha në dekadat e fundit në anën e ofertës në treg.²²

Problematike këtu bëhet edhe një pozicionim i dy vendeve kyçe të Organizatës së Vendeve Eksportuese të Naftës (OPEC), Arabisë Saudite dhe Emirateve të Bashkuara Arabe që të mos rrisin prodhimin e naftës, por t'i përmbahen planeve afatgjata.²³ Një rritje e ofertës së naftës nga ana e Iranit parashihet të stabilizojë për një kohë të caktuar tregun.²⁴ Rritja e çmimeve të karburanteve e rrit koston e transportit, çka ndikon drejtpërdrejt në nxitjen e ndërmarrjeve për rritjen ose jo të prodhimit.

Të dhënat e Doganës së Kosovës për konsumin e naftës dhe benzinës gjatë periudhës janar-mars të viteve 2021 dhe 2022, tregojnë se kërkesa për këto dy produkte në Kosovë nuk ka ndryshuar, ndonëse kemi rritje të ndjeshme të çmimit të tyre. Edhe pse çmimi i dizelit të importuar për njësi gjatë periudhës janar-mars 2022 është rritur për mbi 89%, sasia e importuar ishte për 2.5% më e lartë, ku koeficienti i elasticitetit të kërkesës lidhur me çmimin ishte 0.03. Ngjashëm dhe tek benzina, koeficienti i elasticitetit ishte 0.1 që tregon se kërkesa është jo-elastike. Pra, pavarësisht rritjes së madhe të çmimit të naftës në Kosovë, kërkesa mbetet shumë e lartë.

17 Zyra e Rregullatorit të Energjisë. Burimi: <https://bit.ly/3rhLYx4>

18 Observatory of Economic Complexity. Burimi: <https://oec.world/en/>

19 Journalism for the energy transition. Burimi: <https://bit.ly/3uuJxcs>


20 Observatory of Economic Complexity. Burimi: <https://oec.world/en/>

21 The Economist. Burimi: <https://econ.st/3rfsKrY>

22 The New York Times. Burimi: <https://nyti.ms/3jqxqqE>

23 Ibid


24 JP Morgan. Burimi: <https://bit.ly/3xi2Qrm>

Figura 3. Kërkesa për dizel dhe benzin në Kosovë, janar-mars 2021–2022

Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e Doganës së Kosovës

Produktet ushqimore dhe lënda e parë

Një ndër kanalet tjera kryesore të ndikimit në çmime, për shkak të luftës Ukrainë-Rusi, në ekonominë e vendit tonë është ai përmes rritjes së çmimeve të importit të produkteve ushqimore dhe lëndës së parë. Rusia është eksportuesja më e madhe në botë e grurit me mbi 18% të eksporteve totale vjetore në botë, ndërsa ajo eksporton edhe sasi të larta të elbit me mbi 11.4% pjesëmarrje në tregun botëror. Ndërkaq, Ukraina po ashtu është eksportuesja kryesore në botë e vajrave të farave me 38.8% të eksporteve totale në botë, si dhe me 14.4% të eksporteve totale të misrit.²⁵

Figura 4. Pjesëmarrja e Rusisë dhe Ukrainës në eksportet globale të produkteve ushqimore dhe fertilizuesve, 2019

Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e Observatory of Economic Complexity

²⁵ Observatory of Economic Complexity. Burimi: <https://oec.world/en/>

Sipas një raporti të Agjencisë së Ushqimit dhe Bujqësisë të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (FAO), të publikuar në mars të vitit 2022, ndonëse rënia e eksporteve të grurit dhe misrit nga Rusia dhe Ukraina mund të nxisë orientimin për import tek vendet tjera, sasitë e grurit në stoqe sikurse në Kanada dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë të kufizuara, duke marrë parasysh dhe rënien e rendimentit të grurit në periudhën 2021–2022 në këto vende. Ngjashëm, sipas këtij raporti, edhe eksportet e Argjentinës do të limitohen nga qeveria nën synimin që ta kontrollojë inflacionin në vend, ndërsa Australia vetëm se i ka arritur limitet e saj të dërgesave në aspektin logjistik. Në këtë situatë, secili shtet do të jetë më i kujdesshëm dhe mund të vëjë kufizime në eksportin e grurit për tu mbrojtur edhe nga presionet inflacioniste që mund të shkaktoheshin nga mungesa e këtij produkti në tregun e tyre të brendshëm. Si rrjedhojë, edhe për shkak të pamundësisë së Ukrainës për t'i mbjellur apo korrur produktet sikur misri apo farat e lulediellit, sipas FAO, çmimet e ushqimit gjatë vitit 2022 mund të rriten nga 8 deri në 22%. Ndërkaq, në periudhën afatmesme, skenarët e prezantuar nga FAO parashohin që produktet nga Rusia dhe Ukraina të mund të zëvendësohen nga zgjerimi i prodhimit të shteteve tjera të produkteve sikurse gruri vetëm në shkallën nga 19 deri në 48%, çka mund të ndikojë në prevalencën e çmimeve të larta të produkteve ushqimore edhe në periudhën afatmesme.²⁶

Rusia, po ashtu, është një ndër eksportueset kryesore të plehrave azotike, sikurse është plehi urea, me pjesëmarrje mbi 12% të eksporteve totale globale. Nga fillimi i luftës mes Rusisë dhe Ukrainës, çmimi i këtij produkti në tregjet globale është rritur mbi 10% në baza javore gjatë marsit.²⁷ Gjatë vitit 2021, ky input në bujqësi veçse kishte pasur dyfishim të çmimit mu për shkak të rritjes së çmimit nga eksportuesit nga Rusia, por edhe nga rritja e mënjëhershme e kërkesës globale gjatë vitit 2021 dhe përqendrimi i tregut tek vetëm disa prodhues të mëdhenj në botë të cilët mund të bëjnë marrëveshje për fiksime të çmimit.²⁸ Sipas FAO, në rast se çmimi i naftës vazhdon të rritet, në periudhën pesë vjeçare edhe çmimi i fertilizuesve do të rritet për mbi për mbi 25%.²⁹

Zhvillimet tjera në tregun e brendshëm në Kosovë

Në vitin 2020, Kosova kishte shkallë të vetëmjaftueshmërisë me grurë prej 73% ndërsa me misër 75%. Në periudhën 2016–2019 shkalla e vetëmjaftueshmërisë ishte nga 57 deri në 70%, kurse tek misri vërehet më pak luhajtje (72–77%).³⁰ Gjatë vitit 2021, Kosova ka importuar mbi 84% të grurit dhe 89% të misrit nga Serbia në vlerë rreth 19 milionë euro dhe 11 milionë euro, respektivisht. Ndërsa me fillimin e luftës në Ukrainë, Serbia ka vënë ndalesë për eksportin e vajit, miellit, misrit, dhe grurit në vendet tjera. Mirëpo, nga të dhënat e Doganës së Kosovës, vetëm në tre muajt e parë të vitit 2022, Kosova ka importuar mbi 5.6 milionë euro grurë nga Serbia dhe atë pjesa më e madhe është (mbi 3.5 milionë euro) importuar gjatë muajit mars. Po ashtu, Kosova ka importuar rreth 4 milionë euro misër gjatë TM1 2022, ku mbi 89% është e importuar përsëri nga Serbia.³¹ Në vitin 2019, kur Kosova kishte vënë taksë 100% edhe në lëndën e parë, Kosova kishte importuar grurë dhe misër kryesisht nga Kroacia, Bullgaria dhe Hungaria, që tregon se prodhuesit kosovarë veçse kanë krijuar kontakte biznesore me këto vende. Edhe gjatë vitit 2022, Kosova ka importuar grurë nga Kroacia dhe

26 Food and Agriculture Organization. Burimi: <https://bit.ly/3xpLfh8>

27 Yahoo Finance. Burimi: <https://yhoo.it/3DYEnJ9>

28 Financial Times. Burimi: <https://on.ft.com/3OdoJl1>

29 Food and Agriculture Organization. Burimi: <https://bit.ly/3xpLfh8>

30 Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural e Kosovës. Raporti i Gjellbër 2021. Burimi: <https://bit.ly/3LU0rHp>


31 Dogana e Kosovës. Të dhënat e hapura.

Hungaria, mirëpo në vlera më të vogla, rreth 700 mijë euro nga të dyja këto së bashku. Ngjashëm nga këto tri vende janë importuar dhe misër në vlerë rreth 441 mijë euro gjatë TM1 2022.

Nga produktet të cilat Kosova i importon direkt nga Ukraina dhe Rusia, dhe në të cilat ka varësi më të madhe nga këto vende është llamarinina. Gjatë vitit 2021, Kosova ka importuar mbi 85% të llamarinës prej çelikut jo të lidhur nga këto dy vende me vlerë prej rreth 54 milionë euro. Ndërkaq, totali i importit të Kosovës nga e gjithë bota për këtë produkt ishte rreth 62 milionë euro. Gjatë muajit mars të vitit 2022, nuk është importuar asnjë sasi e këtij produkti nga Rusia, ndërsa nga Ukraina është importuar mbi 1.5 milionë euro. Në furnizimin direkt nga Ukraina, ka biznese të cilat vetëm se janë duke u përballur me probleme në furnizim me parket nga ky vend ku pritjet janë deri në 14 muaj.³²

Figura 5. Importi i llamarinës në Kosovë nga Rusia, Ukraina dhe bota, 2021

2021



Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e Doganës së Kosovës

Po ashtu, Kosova importon nga Rusia rreth një të katërtën e plehëruesve të përdorur në bujqësi, një ndër to është edhe plehu urea. Pra, përkundër që çmimet për këtë produkt janë rritur ndjeshëm nga viti 2021 dhe po vazhdojnë të rriten, tani problematike për firmat kosovare do të jetë dhe sigurimi i furnizimit, sidomos atij direkt.

Figura 6. Importi i plehëruesve në Kosovë nga Rusia dhe bota, 2021




Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e Doganës së Kosovës

Sipas raportit të gjelbër të Ministrisë së Bujqësisë 2021, plehërat sikurse ato të ureas përbëjnë rreth 10% të kostove të konsumit të ndërmjetëm. Ndërsa, energjia elektrike përbën mbi 7.5% të kostove të konsumit të ndërmjetëm.³³ Rritja e shumës nga qeveria për subvencionimin e shumë kulturave në bujqësi, për vitin 2022, bën që të mbulohet rritja e kostonë së inputeve sikurse urea, ndërsa kosto e energjisë elektrike ka mbetur e pandryshuar për fermerët edhe në vitin 2022 sipas tarifave të reja të ZRRE-së dhe nuk paraqet kosto shtesë.

³² Koha Net. Burimi: <https://bit.ly/37GA5Ks>

³³ Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural e Kosovës. Raporti i Gjelbër 2021. Burimi: <https://bit.ly/3LU0rHp>


Figura 7. Struktura e kostove të inputeve në bujqësi në Kosovë, 2020



Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e Ministrisë së Bujqësisë së Kosovës

Nga Rusia dhe Ukraina, në vitin 2021, Kosova e ka siguruar edhe mbi një të tretën e importeve të majës së bukës për bukëpjekësit. Pjesa më e madhe e importit të këtij produkti e kishte origjinën nga Rusia.

Figura 8. Importi i majës së bukës në Kosovë nga Rusia dhe Ukraina dhe Bota, 2021



Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e Doganës së Kosovës

Ndërhyrjet e qeverive gjatë krizës së çmimeve

Janë tri forma kryesore përmes të cilave qeveritë e vendeve fqinje dhe ajo e Kosovës po ndërhyjnë në këtë kohë të krizës së çmimeve: subvencionimi, ulja e normave tatimore apo/dhe kombinimi i të dy opsioneve të para. Deri më tani, Maqedonia e Veriut ka ndërmarrë kryesisht masa që tentojnë të ulin efektin e çmimeve të ngritura duke e reduktuar përkohësisht normën e TVSH-së në produkte bazike, përfshirë këtu dhe energjinë elektrike, si dhe të akcizës për karburante. Në Shqipëri, qeveria ka bërë një ulje të tatimit mbi të ardhurat personale të disa grupeve të qytetarëve, kryesisht me të hyra më të ulëta, ka rritur pagën minimale dhe ka ndarë mjete për subvencionimin e naftës për bujqit si dhe për kompensimin e rritjes së çmimit të transportit publik. Deri më tani, Serbia ka subvencionuar vetëm ndarjen e nga 100 euro për të rinjtë, kurse në Mal të Zi nuk është në fuqi asnjë masë marrë parasysh bllokadën politike në kuvend.

Kosova ka ndarë 100 milionë euro për të mbështetur qytetarët kryesisht me pagesa të njëhershme, me nga 100 euro për të gjithë të punësuarit, pensionmarrësit dhe studentët. Qeveria ka bërë subvencionimin e energjisë elektrike me mbi 120 milionë euro, në mënyrë që të lehtësohet barra tek qytetarët, sidomos tek ata më në nevojë; ka ndarë mjete për rritjen e rezervave shtetërore; ka rritur subvencionimin e kulturave kyçe në bujqësi dhe po subvencionon akcizën e naftës për bujqit. Paralelisht, Qeveria e Kosovës gjatë vitit 2022, është duke ekzekutuar edhe masa që parashohin ndarjen e mjeteve për qytetarët dhe familjet e prekura nga pandemia.

Tabela 1. Masat e Qeverisë së Kosovës dhe shteteve fqinje në raport me situatën ekonomike nga rritja e çmimeve, 2022

Maqedonia e Veriut	Kosova	Shqipëria	Serbia	Mali i Zi
Ulje e TVSH në produkte ushqimore bazë nga 5 në 0% deri në maj 2022 ³⁴	100 milionë euro: nga 100 euro për të punësuarit, studentët, pensionmarrësit dhe 40 mijë pako ushqimore. ³⁵	0% tatim per pagat deri në 335 euro, përgjysmim i tyre deri në 420 euro ³⁶	Subvencionim me nga 100 euro për të rinjtë ³⁷	Asnjë masë në fuqi për shkak të ngecjes së punës së Kuvendit ³⁸
Ulje e TVSH për energjinë elektrike; mbetet 5% deri dhjetor 2022	120 milionë euro subvencionim i energjisë elektrike ³⁹	235 milionë euro subvencionim apo rritje likuiditeti në fushën e energjisë elektrike		
Normë preferenciale e TVSH-së për karburante 10%, dhe ulet akciza për 1,2 ose 4 denarë sipas lëvizjeve në bursë	10 milionë euro për rritjen e rezervave shtetërore ⁴⁰	12 milionë euro për naftë pa taksa për fermerët		
0% TVSH për importin e energjisë elektrike	5 milionë euro apo 36 cent për litër për subvencionimin e naftës për bujqësi, si dhe ulje e marzhës së fitimit në naftë	4.2 milionë euro për kompensimin e rritjes së çmimit të transportit publik		
Shpërndarja e kuponëve për pako ushqimore	Dyfishim i subvencionimit të kulturave kyçe në bujqësi për vitin 2022	27.5 milionë euro për indeksimin e pensioneve		
Shpenzime tjera të qeverisë	Masa tjera nga Pako e Ringjalljes Ekonomike të cilat kanë filluar në vitin 2021 dhe janë duke u aplikuar gjatë vitit 2022, sikurse për personat që kanë humbur vendin e punës apo të afërmit gjatë pandemisë, shpërndarja e pakove ushqimore, rritje e pensioneve bazike etj.	Paga minimale rritet në rreth 267 euro.		

34 Dogana e Maqedonisë së Veriut. Burimi: <https://bit.ly/3O1i9L7>

35 Zyra e Kryeministrit të Kosovës. Burimi: <https://bit.ly/3xmHZU0>

36 Ministria e Financave dhe Ekonomisë në Shqipëri. Burimi: <https://bit.ly/3utsisk>

37 Ministria e Financave të Serbisë. Burimi: <https://bit.ly/3jqhJl>

38 Balkan Insight. Burimi: <https://bit.ly/3JyzKGG>

39 Ministria e Financave dhe Zyra e Kryeministrit të Kosovës.


40 Zyra e Kryeministrit të Kosovës. Burimi: <https://bit.ly/3772ucw>

Përfundim

Pushtimi rus i Ukrainës ka ndikuar në një rritje të ndjeshme të çmimeve të produkteve bazë. Marrë parasysh se Kosova është neto importuese e shumicës së produkteve, rritja e çmimeve është reflektuar menjëherë edhe këtu. Ndonëse nuk dihet se kur do të përfundojë lufta mes këtyre dy shteteve, pritjet janë që në periudhën afatmesme të mos ketë stabilizim të çmimeve të konsumit dhe zëvendësim të lehtë të prodhimit që vije nga Rusia me produkte të vendeve tjera. Lidhur me situatën aktuale, Instituti GAP rekomandon që:

- Ndonëse qeveria është duke implementuar disa masa në kuadër të Pakos së Ringjalljes të cilat i ndihmojnë disa shtresa të qytetarëve, shumica nga to ndërlidhen me ngjarjet gjatë vitit 2020 apo 2021, andaj është e nevojshme të dizajnohen dhe disa masa që ndërlidhen me rritjen e kostos së shportës së konsumit për qytetarët në nevojë. Këtu mund të përfshihen shpërndarja në vazhdimësi e pakove apo kuponëve ushqimorë, të rishikohet vlera aktuale e shumës së Skemës së Asistencës Sociale për një familje nëse është e mjaftueshme që t'i mbrojë ato nga rënia nën kufirin e varfërisë, të përkrahen qytetarët që mund të humbin vendin e punës, dhe më shumë;
- Qeveria të rrisë pagën minimale mirëpo të jetë e kujdesshme që ajo të mos kalojë një kufi të pagës mediane, e cila tregon vlerën e pagës ndër të cilën paguhen 50% e qytetarëve, siç sugjerojnë praktikrat e vendeve tjera. Një pagë minimale më e lartë sipas këtij parimi do të ua lehtësonte përballimin e situatës punonjësve të sektorëve privat, të cilët marrin paga jo të larta, si dhe njëkohësisht nuk do të shkaktonte kundërefekt në tregun e punës (humbje të vendeve të punës);
- Qeveria duhet të jetë e kujdesshme që të mos ndërmarr politika të cilat janë pro-ciklike, pra që e stimulojnë edhe më tej kërkesën e madhe agregate për produktet e shtjelluara në këtë analizë, e që mund të kenë kundërefekt në ekonomi. Veçanërisht, iniciativa e disa deputetëve që qytetarëve t'u lejohet tërheqja e 30% të kursimeve në Trustin pensional përveç se e dëmton stabilitetin e financave publike ka efekt të kundërt me pritjet;
- Marrë parasysh kërkesën jo-elastike të qytetarëve në Kosovë lidhur me produktet e naftës, qeveria duhet të dizajnojë masa që i nxisin qytetarët të përdorin më pak veturat, sikurse duke e lejuar qarkullimin e veturave sipas një rregulli, duke përkrahur iniciativa të tilla sikurse "e diela pa vetura", nisma që stimulojnë udhëtimet në grup, si dhe të gjejë forma për subvencionimin e transportit publik;
- Qeveria, Zyra e Rregullatorit të Energjisë dhe akterët kryesorë në tregun e energjisë duhet të koordinohen që të elaborojnë opsionet për shfrytëzimin e strategjive mbrojtëse lidhur me blerjen e energjisë elektrike për ta minimizuar riskun, marrë parasysh indikacionet për çmime të larta të energjisë elektrike edhe gjatë vitit 2022;
- Subvencionimi në bujqësi sikurse i kulturave por edhe akcizës në naftë është i dizajnuar mirë që të inkurajojë prodhimin dhe ato duhet të vazhdojnë të jenë në një nivel të lartë deri në normalizimin e çmimeve.

Instituti GAP është think-tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.



Instituti GAP përkrahët nga:

